



Republika e Kosovës Republika Kosovo / Republic of Kosovo

Drejtoria për Buxhet dhe Financa
Odeljenje za Budžet i Finansije-Department of Budget and Finance

RAPORTI I PUNËS JANAR-SHTATOR 2025

Përmbajtja

HYRJE.....	2
1. SEKTORI PËR BUXHET DHE FINANCA.....	3
2. BUXHETI 2025.....	3
3. PUNËT E REALIZUARA JANAR - SHTATOR	4
4. JANAR- SHTATOR - BUXHET, ALOKIM, SHPENZIM	4
4.1 Paraqitja grafike	5
5. TË HYRAT VETANAKE	5
6. SEKTORI I TATIMIT NË PRONË	5

HYRJE

- Ky raport përfshinë të dhënat për periudhën Janar- Shtator 2025 nga Drejtoria për Buxhet dhe Financa, konkretisht nga sektori për Buxhet dhe Financa dhe sektori i Tatimit në Pronë.

1. SEKTORI PËR BUXHET DHE FINANCA

- Bazuar në obligimet ligjore të cilat dalin nga Ligji mbi Financat Publike dhe Përgjegjësitë, ne si drejtori konsiderojmë se kemi kryer të gjitha detyrat dhe obligimet që i takojnë kësaj drejtorie.
- Në Drejtorinë e Financave kemi arritur që detyrat të kryhen në afate ligjore dhe çdo e hyre dhe shpenzim të evidentohet, në sistemin e SIMFK dhe data bazën e brendshme.
- Gjate kësaj periudhe jemi ballafaquar edhe me zbatimin e kontratës kolektive në arsim, me ekzekutimin e urdhërave përmbartimorë nga ana e thesarit për këtë lloj destinimi, ku vlera e këtij shpenzimi arrinë përafërsisht mbi 2 milion euro, mjete të cilat janë tërhequr nga kategoria e investimeve kapitale, mallra dhe shërbime dhe shpenzimet Komunale, gjë që na ka zvogëluar buxhetin në masë të konsiderueshme.
- Gjithashtu kemi mbajtur disa takime me Ministrinë e Financave, me AKK dhe organizata të ndryshme apo donator që kryesisht janë trajtuar çështjet financiare.
- Deri në këtë periudhë kemi arritur shpenzimin e buxhetit në një shume të konsiderueshme duke përfshirë të gjitha kategoritë ekonomike (paga dhe mëditje, mallëra dhe shërbime, subvencione dhe transfere dhe Investime kapitale), në shumën prej 18,809,784.38 Euro.

2. BUXHETI 2025

➤ Buxheti i Komunës së Rahovecit për vitin 2025 ndahet në dy fonde burimore:

- Grandi i qeveritar18,981,085.00 €
- Të hyrat vetanake2,001,711.00 €
- Gjithsej:.....20,982,796.00 €

➤ Buxheti final për vitin 2025 i shpërndarë sipas kategorive ekonomike:

- Paga dhe Mëditje 11,217,273.21€
- Mallra dhe Shërbime..... 2,811,100.03 €
- Shpenzime Komunale390,000.00 €
- Subvencione dhe Transfere1,060,000.00 €
- Investime Kapitale..... 6,749,669.70 €
- Total: 22,228,042.94 €

3. PUNËT E REALIZUARA JANAR - SHTATOR

➤ Gjatë kësaj periudhe kemi realizuar këto detyra:


- Zotime, pranime, shpenzime për mallra dhe shërbime, shërbime komunale, subvencione dhe transfere, dhe investime kapitale dhe përgatitja e ndryshimeve në listën e pagave për punëtor.
- Bartja e të hyrave vetanake nga viti 2024 në vitin 2025.
- Shpërndarja e faturave të tatimit në pronë
- Përgatitja e raportit financiar në baza tremujore 2025 për Kuvendin Komunal dhe Kryetarin e Komunës.
- Raportimi i obligimeve financiare, dhe kontraktuale në baza mujore në Ministrinë e Financave, Punës dhe Transfereve.
- Përgatitja e raporteve mujore dhe tremujore (shpenzimet dhe të hyrat) për publikim në Web faqen e Komunës së Rahovecit.

4. JANAR- SHTATOR - BUXHET, ALOKIM, SHPENZIM

Përshkrimi	Lëndët e kryera	Buxheti fillestar	Buxheti final	Alokimet	Shpenzimet	Shpenzim/ Buxheti final %	Shpenzim /Alokim %
Paga dhe Mëdtije	-	10,746,449.00	11,217,273.21	9,425,609.00	8,664,831.90	77.25%	91.93 %
Mallra dhe Shërbime	1480	2,590,408.00	2,811,100.03	2,778,217.07	2,497,532.07	88.85%	89.90 %
Shpenzime Komunale	429	390,000.00	390,000.00	390,000.00	323,177.74	82.87%	82.87 %
Subvencione dhe Transfere	166	1,010,000.00	1,060,000.00	901,007.19	899,344.05	84.84%	99.82 %
Investime Kapitale	119	5,254,228.00	6,749,669.70	6,586,130.08	6,424,898.62	95.19%	97.55 %
Totali	2194	18,981,085.00	22,228,042.94	20,080,963.34	18,809,784.38	84.62%	93.67 %

- Sqarim: Dallimi ndërmjet buxhetit fillestar dhe final është për arsye të bartjes së mjeteve të mbetura nga viti 2025, Donacionet dhe Grantet.

4.1 Paraqitja grafike



5. TË HYRAT VETANAKE

- Të hyrat e përgjithshme vetanake të planifikuara për vitin 2025 janë 2,001,711.00 euro, për këtë periudhë janë realizuar në shumë 950,330.26 euro apo 47.48% të planifikimit vjetor.

6. SEKTORI I TATIMIT NË PRONË

- Gjatë periudhës Janar-Shtator 2025 sektori i tatimit në pronë ka realizuar të hyra në shumë prej 256,842.02 euro apo 45.26 % vjetor (planifikimi vjetor 567,464.00) ndërsa tatimi në tokë ka realizuar të hyra prej 276,611.09 euro apo 142,632.09 tejkallim të planit vjetor (planifikimi vjetor 133,979.00).
- Regjistrimet e reja janë 204 objekte, ose 36,930 m2. Verifikimi i objekteve 1918 ose 310,938 m2.

Vërejtje:Për arsye të përditësimit të programit të Tatimit në Pronë nga departamenti i Tatimit në Pronë nuk ka qënë e mundur te gjenerohen të dhëna për tre mujorin e tretë (TM3) të viti 2025!

Të gjitha të dhënat që janë të paraqitur janë përgatitur në bazë të raporteve deri me 30.10.2025

Drejtoria për Buxhet dhe Financa

